

**STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"SPECTRUM SOLARIS" sh.p.k**

**EMERTIMI-SELIA-OBJEKTI-KOHEZGJATJA**

**Neni 1 - Emertimi**

Shoqeria krijohet ne formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar. Emertimi i shoqerise eshte "SPECTRUM SOLARIS" sh.p.k (ne vijim e quajtur "Shoqeria").

Shoqeria eshte themeluar sipas ligjit 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar si dhe fiton personalitet juridik ne momentin e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, me Aktin e Themelimit dhe me kete Statut.

**Neni 2 - Selia**

Selia e shoqerise ndodhet ne adresen Lagja nr. 8 Rruga "Familja e Peshkatarit" Nr. 7454, Durres, Shqiperi.

Shoqeria mund te hape dege, zyra perfaqesie dhe te krijoje filiale ne qytete te ndryshme te Republikes se Shqiperise dhe/ose jashte saj me vendim te Asamblese se Ortakeve.

**Neni 3 - Objekti**

Shoqeria ka per objekt veprimtarite e me poshtme:

- Studim, projektim, zbatim, prodhim dhe tregtim i energjisë elektrike nga burime alternative si sistemet fotovoltaike, parqet e eres, termocentralet, biomasa etj.
- Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese (fotovoltaike, eolike, hidrike) te energjisë elektrike, te cilat shfrytezojnë burimet e rinojueshme te energjisë elektrike si dielli, era, uji si dhe i veprave te tyre ndihmese. Perfshire dhe pa u kushtezuar vetem ne marrjen e te gjitha lejeve, licensave dhe autorizimeve paraprake/perfundimtare, institucionet per gjegjese shteterore (qofshin keto organe Qendrore apo Vendore), apo private te cilat mundesojnë zhvillimin e ketyre aktiviteteve ne menyre te qete dhe ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.
- Shitia me shumice dhe pakice e energjisë elektrike tek operatoret, furnizuesit, tregtaret, konsumatoret e energji ise elektrike (vendas apo te huaj), si dhe ne Bursen Shqiptare te Enerjisë Elektrike (ALPEX), apo Bursa te tjera te energjisë jashte vendit.

Perveç sa me siper, Shoqeria mund te kryeje edo aktivitet qe lidhet direkt ose indirekt, qe eshte rezultat ose lidhet me objektin e mesipermit. Per arritjen e qellimit te mesipermit, Shoqeria mund te kryeje edo transaksion lidhur me pasurite e luajtshme dhe te paluajtshme, dhe edo aktivitet tjeter tregtar, financiar, qiraje ose hipoteke, qe mund te konsiderohet i vlefshem ose i nevojshem ne menyre qe te ushtrohet objekti i Shoqerise. Duke perfshire por pa u kufizuar ne linjat elektrike te tensionit te larte dhe te mesem, nenstacione elektrike dhe njesi te tjera te lidhjeve elektrike, rrugeve te aksesit etj., si dhe edo aktivitet aksesor i lidhur me sa me siper, si

punime germimi, punime per prishjen dhe punime te tjera te tokes, punime civile, elektrike dhe mekanike te cdo lloji si dhe blerje, shitje, shkembim, import-eksport te pajisjeve, riparim dhe mirembajtje te materialeve dhe pajisjeve dhe te gjithe aktivitetet e lidhura me keto ceshtje, gjithashtu dhe ne fushen e aktiviteve te tregtimit.

#### Neni 4- Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj nga data e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar Shqiptar per nje periudhe kohore te pakufizuar. Asambleja e Ortakeve mund te shkuroje kohezgjatjen e Shoqerise.

#### Neni 5- Kapitali Themeltar

5.1 Kapitali themeltar i shoqerise eshte 10,000 Lek (dhjete mijë lek). Kapitali eshte i perbere nga 4 kuota me vlore perkatesisht sipas kontributeve.

Kapitali themeltar ne para eshte nenshkruar nga Ortaket e Shoqerise si me poshte:

- **Eranda Metalla**, lindur ne Durres, Shqiperi me date 26.06.1999, mbajtese e leternjoftimit nr. personal J95626072L, me zotesi te plete per te vepruar, zoteruese e 1 kuote me vlore 3,400 Lek qe perfaqeson 34% te kapitalit;
- **Arsela Vogli**, lindur ne Tirane, Shqiperi me date 16.06.1993, mbajtese e leternjoftimit nr. personal J35626066H, me zotesi te plete per te vepruar, zoteruese e 1 kuote me vlore 3,300 Lek qe perfaqeson 33% te kapitalit;
- **Sara Vora**, lindur ne Durres, Shqiperi me date 12.09.1994, mbajtese e leternjoftimit nr. personal J45912013D, me zotesi te plete per te vepruar, zoteruese e 1 kuote me vlore 1,650 Lek qe perfaqeson 16.5% te kapitalit.
- **Elvina Hajri**, lindur ne Durres, Shqiperi me date 27.12.1990, mbajtese e leternjoftimit nr. personal J06227013J, me zotesi te plete per te vepruar, zoteruese e 1 kuote me vlore 1,650 Lek qe perfaqeson 16.5% te kapitalit.

5.2 Pergjegjesia e ortakeve per detyrimet e Shoqerise ndaj te treteve shtrihet deri ne kufirin e kontributit te tyre ne kapitalin e Shoqerise.

5.3 I gjithe kapitali themeltar eshte nenshkruar dhe zoterohet teresisht nga Ortaket e Shoqerise.

#### Neni 6 – Zmadhimi i kapitalit

Kapitali themeltar mund te zmadhohet nepermjet kontributeve te reja nga ana e ortakut ose me kalimin e fondev te destuguara ne rezerve ose te fondev te tjera te pasqyruara ne bilanc persa jane te disponueshme, kjo ne perputhje me legjisacionin ne fuqi si dhe permes cdo menyre tjeter te percaktuar nga legjisacioni ne fuqi dhe sipas percaktiveme nga Asambleja e Ortakeve ne lidhje me kete ceshtje. Vendimi perkates i Asamblese se Ortakeve merret ne perputhje me shumicen e parashikuar ne lidhje me ndryshimet e ketij Statuti.



## Neni 7 – Transferimi i kapitalit

7.1 Kuotat e zoteraura nga secili ortak i Shoqerise jane lirisht te transferueshme dhe mund te transferohen ne cdo kohe ne perputhje me kushtet dhe afatet qe percaktohen ne kete Statut dhe ne ligjin shqiptar.

7.2 Per transferimin e kuotave te Shoqerise tek te tretet nuk eshte i nevojshem miratimi i Asamblese se Ortakeve te Shoqerise. Ortaket e Shoqerise konfirmojne dhe pranojne se ata nuk do te pengojne, cenojne apo kufizojne ne ndonje menyre njeri – tjetrin per te transferuar tek te tretet kuotat qe ata zoterojne personalisht ne Shoqeri.

## ASAMBLEJA E ORTAKEVE – ADMINISTRIMI I SHOQERISE

### Neni 8 – Asambleja e Ortakeve

#### 8.1 Funksionet dhe Kompetencat

Ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi, Asambleja e Ortakeve, e thirrur rregullisht perfaqeson te gjithe ortaket dhe eshte organi me i larte vendimmarres i Shoqerise.

Asambleja e Ortakeve vendoz, por pa u kufizuar, mbi sa me poshte:

- a) Ndryshimin e statutit;
- b) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) Emerimin dhe shkarkimin e likuidatoreve dhe te eksperteve kontabel;
- d) Miratimin e shperblimit te administratoreve, likuidatoreve dhe te eksperteve kontabel;
- e) Percaktok politikat tregtare te shoqerise dhe mbikqyrjen e zbatimin e politikave tregtare nga organi i administrimit perfshire perqatjen e pasqyrave financiare dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- f) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
- g) Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- h) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- i) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj organit te administrimit;
- j) Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- k) Miratimin e rregullave proceduale te mbledhjeve te asamblese;
- l) Miratimin dhe shperndarjen e fitimeve
- m) Cdo ceshtje tjeter te parashikuar nga ligji ose ky Statut.

Asambleja e Ortakeve per ndryshimin e statutit, shperndarjen e fitimeve, zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise merr vendime te vlefshme nese marrin pjese ose jane te perfaquesuar ne asamble ortaket me te drejte vote qe zoterojne me shume se gjysmen e kapitalit te Shoqerise. Ne rast se kuorumi nuk arrihet, Asambleja e Ortakeve do te mblidhet Brenda 30 diteve me te nejtin rend dite. Vendimet merren me voten e  $\frac{3}{4}$  e ortakeve te pranishem ose te perfaquesuar.

Asambleja e Ortakeve per ceshtje te tjera nga ato te treguara me siper, mblidhet rregullisht kur jane te pranishem ortaket qe perfaqesojnë 30% te kapitalit te Shoqerise. Ne rast se kuorumi nuk

arrihet, Asambleja e Ortakeve do te mblidhet Brenda 30 diteve me te njejtten rend dite. Vendimet merren me voten e me shume se  $\frac{1}{2}$  e ortakeve te pranishem ose te perfaqesuar.

Cdo ortak qe ka te drejte te marre pjese ne Asamblene e Ortakeve mund te perfaqesohet edhe nga persona qe nuk jane ortake. Akti i perfaqesimit duhet te jete me shkrim dhe te tregojem emrin e perfaqesuesit. Akti i perfaqesimit duhet te leshihet vetem per nje asamble e cila perfshin edhe mbledhjet pasardhese te Asamblese se Ortakeve me te njejtin rend dite. Asambleja e Ortakeve kryesoher nga Administratori i Vetem.

### **8.2 Vendi i mbledhjeve**

Asambleja e Ortakeve mblidhet ne Shqiperi dhe jashte territorit te saj, ashtu sic tregohet ne njoftimin per mbledhjen e Asamblese se Ortakeve.

Mbledhjet e Asamblese se Ortakeve mund te zhvillohen edhe nepermjet mjeteve elektronike si audio konference dhe video konference me kusht qe: (a) qe te jene te pranishem ne te njejtin vend kryetari dhe sekretari i mbledhjes, ne rast se eshte emeruar, te cilet do te perpilojnë dhe nenshkruajne procesverbalin meqenese mbledhja do te konsiderohet e mbledhur ne vandin ku jane ata; (b) t'i mundesohet kryetarit te mbledhjet te verifikoje identitetin e personave qe marrin pjese ne mbledhje, te verifikoje rregullsine e mbledhjes, te verifikoje dhe te shpallo resultatet e votimeve; (c) t'i mundesohet sekretarit qe te marre ne menyre te rregullt cdo nderhyrje object i procesverbalit; (d) t'i mundesohet pjesemaresve ne mbledhje qe te diskutojne dhe te votojne ne kohe reale mbi rendin e dites, si dhe te shqyrtojne, te marrin dhe te transmerojne dokumenta. Vendimet e mbledhjeve do te regjistrohen ne procesverbal te nenshkruar nga kryetari dhe sekretari i emeruar here pas here ne asamble.

### **8.3 Njoftimi i Asamblese se Ortakeve**

Asambleja e Ortakeve thirret e pakten nje here ne vit dhe ne rastet e parashikuara nga legjislativni shqiptar mbi shoqerite tregtare.

Njotimi i dergohet ortakeve me poste te regjistruar te pakten 7 dite perpara dates se fiksuar per Asamblene e Ortakeve dhe duhet te permboje rendin e dites, oren dhe vandin e mbledhjes.



Vendimet e mbledhjeve te Asamblese se Ortakeve do te regjistrohen ne procesverbal te nenshkruar nga kryetari dhe sekretari i emeruar here pas here ne asamble.

## **Neni 9 – Administrimi i Shoqerise**

9.1 Shoqeria administrohet nga nje Administrator i vetem.  
Administrator i vetem:

- Mund te mos jete ortak;
- Do te ushtroje detyren per nje periudhe qe do te percaktohet kohe pas kohe nga Asambleja e Ortakeve ne aktin e emerimit, e cila ne asnjë rast nuk mund te jete me e gjate se 5 vite;

Perjashtimi, detyren e pare te Administratorit te Vetem do ta ushtroje:



z. Tomir Haxhiraj , lindur ne Tirane, Durres me date 20.03.1991, mbajtes i leternjoftimit nr.personal J10320105E.  
Administratori i Shoqerise ushtron kompetencat e tij sic parashikohet nga dispozitat e ligjit.

#### Neni 10 - Kontrolli

Nese kerkohet nga ligji, eksperti emerohet nga Asambleja e Ortakeve. Asambleja e Ortakeve mund te riemeroje te njejtin ekspert. Eksperti shkarkohet nga detyra me vendim te Asamblese se Ortakeve ne rast mosrespektimi te detyres se tij, ne rast gabimi dhe ne rast mungese profesionalizmi ne sjellje.

#### Neni 11 - Viti Ushtrimor

Viti ushtrimor i shoqerise fillon me date Janar dhe mbylllet me date 31 Dhjetor te cdo viti. Perjashtimisht, viti i pare ushtrimor fillon nga data e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbylllet me date 31 Dhjetor 2023.

#### Neni 12 - Prishja dhe Likuidimi

Ne rast prishje dhe likuidimi te Shoqerise, per cfaredo arsye dhe ne cdo moment, Asambleja e Ortakeve do te emeroje lukidatorin ose likuidatoret ne perputhje me dispozitat e legjisacionit shqiptar ne fuqi.

#### Neni 13 - Ligi i Zbatueshem

13.1 Per sa nuk parashikohet ne kete Akt Themelimi, do t'i behet shprehimisht reference Statutit te Shoqerise dhe legjisacionit shqiptar ne fuqi ne fushen e shoqerive tregtare, vecanerisht ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar.  
13.2 Cdo mosmarreveshje qe mund te linde ne lidhje me zbatimin dhe interpretimin e ketij Akti Themelimi si dhe cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe ortakeve, apo midis vete ortakeve, qe nuk mund te zgjidhet ne mirekuptim midis tyre, do te zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

#### Neni 14 - Te ndryshme

Ky Statut hartohet ne 4 (kater) kopje origjinale ne gjuhen shqipe, me te njeften vlere secila dhe u nenshkrua rregullisht nga ortaket.

Ky Akt Themelimi dhe Statut u lexua, pranua e nenshkrua nga ortaket e Shoqerise, i cili autorizon administratorin per te ndjekur procedurat e nevojshme per regjistrimin e shoqerise ne regjistrin tregtar shqiptar, prane QKB Tirane.

Tirane, 25 Prill 2023

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE TREGTARE

"SPECTRUM SOLARIS" SH.P.K

Eranda Metalla

E  
randa  
Arsela  
Sara  
Elvina

Metalla  
Vogli  
Vora  
Hajri

Cagaji.  
~~Metalla~~  
~~Vogli~~  
~~Vora~~  
~~Hajri~~

Arsela Vogli

Sara Vora

Elvina Hajri